



VENDIM

Nr. 140, Datë 15.08.2016

MBI

**LICENSIMIN E SHOQËRISË “GAVRAN ENERGY” SH.P.K NË
AKTIVITETIN E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA
HEC-ET “GAVRAN 1” ME FUQI TË INSTALUAR 998 KW DHE
“GAVRAN” ME FUQI TË INSTALUAR 1215 KW, ME FUQI TOTALE
TË INSTALUAR 2213 KW**

Në mbështetje të neneve 16; 37, pika 2 gërma “a” të Ligjit Nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, nenit 21 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licensave në sektorin e energjisë elektrike” të miratuar me Vendimin e Bordit të ERE-s, Nr. 109, datë 29.06.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 15.08.2016, mbasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “Gavran Energy” sh.p.k., si dhe relacionin e Drejtorisë së Liçensimit dhe Monitorimit të Tregut për liçensimin në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike të kësaj shoqërie,

Konstatohet se :

Aplikimi i shoqërisë “Gavran Energy” sh.p.k., plotëson tërërisht kërkesat e parashikuara nga ERE në “Rregulloren për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licensave në sektorin e energjisë elektrike” si më poshtë:

- Formati i aplikimit (neni 9, pika 1, gërma “a”, “b”, “c”) është plotësuar në mënyrë korrekte;
- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2 gërma “a”, “b”, “c”, “d”, “e”, “f”, “g”) është plotësuar në mënyrë korrekte;
- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3 gërmat “a”, “b”, “c”, “d”) është plotësuar në mënyrë korrekte;

- Dokumentacioni tekniko – ekonomik (neni 9, pikat 4.1.1, 4.1.2, 4.1.3; 4.1.4 dhe 4.1.5, është plotësuar në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të licensojë shoqërinë “Gavran Energy” sh.p.k., në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga Hec-et “Gavran 1” me fuqi 998 KW dhe “Gavran” me fuqi 1215 KW, me fuqi totale të instaluar 2213 KW, për një afat 30 – vjeçar.
2. Drejtoria e Liçensimit, Monitorimit të Tregut dhe të të Licensuarve të njoftojë aplikuesin për Vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.